

20162184799

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR EMETIMIN DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 10 DHE 50 DENARË

1. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë emeton kartëmonedha me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë, si mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë.

2. Kartëmonedhat në vlerë prej 10 dhe 50 denarë, do të shtypen në shtresë speciale – substrate e përpunuar nga polipropileni orientuar biaksial, i cili gjatë shtypjes me përdorimin e procesin të gravimit jep patejdukshmëri tek paratë, përveç në pjesën e dritares transparente me motiv.

Kartëmonedhat me vlerë nominale 10 denarë, kanë dimensione prej 126 mm gjatësi dhe 63 mm gjerësi.

Kartëmonedhat me vlerë nominale 50 denarë, kanë dimensione prej 129 mm gjatësi dhe 63 mm gjerësi.

3. Kartëmonedhat nga pika 1 e këtij vendimi, kanë këto karakteristika:

3.1 Vlerë nominale 10 denarë

Motivi bartës i anës së përparme të parasë me vlerë nominale 10 denarë, është paraqitja e bustit prej mermeri të perëndeshës Izida, (shekulli 2 p.e.s.), artefakt i zbuluar në rrethinën e Ohrit.

Në anën e majtë në çerekun e sipërm të kartëmonedhës është vendosur elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar i kapitalit jonik (fillimi i shekullit të 6-të) në kombinim me ngjyra të cilat kur e mbulojnë njëra-tjetrën, formojnë një tërësi kur shihen nën dritë.

Në këndin e djathtë të çerekut të parë gjendet numri "10", 18 mm i lartë. Në hijen e numrit ka shirita ngjyrash që përmbajnë shkronja "НБРМ" (BPRM) dhe numrin "10" të cilat përsëriten. Në pjesën e pasme të numrit shirita ngjyrash në formë të vizatimeve të stilizuara vektoriale të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike.

Në mes në pjesën e sipërme të çerekut të dytë të parasë, gjendet gijosha (guilloche) një element dekorativ i punuar me një kombinim precizë të vijave të cilat përsëriten me detaje të hollësishme, të aplikuara në të katër anët e parasë.

Në këndin e djathtë në pjesën e sipërme të çerekut të dytë qëndron teksti "Десет денари" (Dhjetë denarë), 5 mm i lartë.

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë është shtypur shenja e njohjes për personat me vështirësi në të pamur në formë të një trekëndëshi të shtrirë.

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë, grafikisht është paraqitur një vathë ari në formë të hënës (shekulli i 2-të p.e.s.).

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë është paraqitur dritarja e tejdukshme me një vizatim të shkëlqyer stilizues të një palloi, të marrë direkt nga detajet e mozaikut të bukur të bazilikës peshkopale të qytetit të lashtë të Stobit. Një imazh i ngjyrosur shtrihet në dritare me pjesë të detajeve të puplave të bishtit të palloit nga mozaiku.

Mes çerekut të dytë dhe të katërt, në fund të pjesës së shtypur të parasë, gjendet një tekst "Изида, мермерно торзо, II век п.н. ера – Охрид" (Izida, bust prej mermeri, shek. II p.e.s. - Ohër), i shkruar vertikalisht me shkronja të vogla.

Në pjesën e majtë të çerekut të tretë, gjendet busti prej mermeri i Titus Flavius Philoxenia (shek. II). Nën bust, me shkronja të vogla është shkruar tekst i cili shënon vendin dhe datën e emetimit të parasë, dhe nën atë tekst, gjendet nënshkrimi i Guvernatorit dhe teksti "Гувернер" (Guvernator).

Në pjesën e poshtme, mes çerekut të tretë dhe të katërt të parasë, është i shkruar mikroteksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë). Nën të qëndron teksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 3 mm i lartë.

Në këndin e djathtë të poshtë të çerekut të fundit, është numri "10", 5 mm i lartë.

Motivi bartës i pamjes së prapme të parasë është paraqitja e një palloi, si pjesë e mozaikut të dhomës së pagëzimit të Bazilikës Peshkopale në qytetin antik të Stobit (shekulli i 6-të).

Në pjesën e sipërme dhe të poshtme të parasë gjendet mikroteksti "НБРМ" (BPRM) dhe "10", i cili përsëritet në sfond të ndryshme, në kombinim negativ dhe pozitiv me ngjyra që përputhen me ngjyrat e parasë.

Në çerekun e parë të këndit të majtë të lart, gjendet numri "10", 5 mm i lartë.

Mes çerekut të parë dhe të dytë, qëndron tekst "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 3 mm i lartë. Numri serik i parasë i cili përmban 2 shkronja dhe 6 numra, është i shtypur në pjesën e mesme të çerekut të parë dhe të tretë të parasë në pozicion vertikal, ndërsa në çerekun e katërt të parasë, në pozicion horizontal.

Në këndin e majtë të çerekut të dytë, janë paraqitur vija në formë të vizatimeve të stilizuara vektoriale, të cilat përsëriten dhe formojnë forma unike të punuara sipas detajeve nga mozaikët e hershëm krishterë nga Stobi dhe Heraklea, të cilat vazhdojnë edhe në çerekun e katërt. Në mes të pjesës së sipërme të çerekut të dytë, është shkruar teksti "Паун, мозаик, VI век – Стоби" (Pallua, mozaik, shekulli VI - Stobi).

Në pjesën e sipërme të djathtë të çerekut të dytë, është vendosur elementi i regjistrimit - një vizatim i stilizuar i kapitalit jonik (fillimi i shekullit të 6-të).

Në pjesën qendrore të majtë të çerekut të tretë dhe pjesës qendrore të djathtë të çerekut të katërt të parasë, është vendosur një vizatim i stilizuar i një mozaiku të dyshemesë nga qyteti i lashtë i Stobit, i cili kur paloset paraqet formon pamje të plotë.

Në këndin e poshtëm të majtë të çerekut të tretë qëndron teksti "Десет денари" (dhjetë denarë), 5 mm i lartë.

Në këndin e majtë të çerekut të katërt qëndron numri "10", 18 mm i lartë. Në hijen e numrave ka vija që përmbajnë shkronjat "НБPM" (BPRM) dhe numrin "10" që përsëriten.

Kartëmonedhat janë shtypura në nëntë ngjyra, dhe në pjesën e përparme dominon ngjyra rozë-vjollce.

3.2 Vlerë nominale 50 denarë

Motivi bartës i pamjes së përparme të parasë me vlerë 50 denarë, është gravurë e një pjese e ikonostasit të manastirit "Shën Pantelejmon" dhe gravurë e monedhës së hershme bizantine.

Në çerekun e parë të pjesës së majtë lart të parasë, është vendosur elemneti i regjistrimit – portreti i Arhangjel Gavrililit në kombinim me ngjyra të cilat kur mbulojnë njëra tjetrën formojnë një tërësi kur shihen nën dritë.

Në këndin e djathtë të çerekut të parë qëndron numri "50", 18 mm i lartë. Në hijen e numrit ka shirita ngjyrash që përmbajnë shkronja "НБPM" (BPRM) dhe numrin "50" që përsëriten.

Në mes në pjesën e sipërme të çerekut të dytë të parasë gjendet gijosha (guilloche), një element dekorativ i punuar nga një kombinim i saktë i linjave të përsëritura me detale të hollësishme, të aplikuara në të katër anët e parasë.

Në këndin e djathtë të sipërm të çerekut të dytë qëndron teksti "Педесет денари" (pesëdhjetë denarë), 5 mm i lartë.

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë është shtypur shenja e njohjes për personat me vështirësi në shikim në formë të dy trekëndëshave të shtrirë.

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë grafikisht është paraqitur një varëse bronzi në formë trekëndëshi (shekulli 7-6-të p.e.s.).

Mes çerekut të parë dhe të tretë të parasë është paraqitur një dritare e tejdukshme me një vizatim të shkëlqyer dhe të stilizuar të motivit bartës të parasë. Vizatimi në pjesën e poshtme të dritares është frymëzuar nga motivet që rrethojnë afreskun e Arhangel Gavrililit në kishën "Shën Gjergji" në Kurbinovë. Një imazh i ngjyrosur derdhet në dritare me qarqe që rrezatojnë rreth monedhës.

Mes çerekut të dytë dhe të katërt, në fund të pjesës së shtypur të parasë, në mënyrë vertikale dhe me shkronja të vogëla është i shkruar teksti "Детал од иконостас, Црква Св. Пантелејмон, XII век - Скопје. Бакарен фолис, Јустин II, VI век". (Detal i ikonostasit, Kisha e Shën Pantelejmonit, shekulli i XII – Shkup. Folis bakri, Justin II, shekulli VI).

Në pjesën e majtë të çerekut të tretë, janë paraqitur dy gjarpërinj të ndërthurur me krahë, detal i një dere me dy krahë të gdhendur cekët, (shek. 16). Nën imazhin e gjarpërinjve, është shkruar një tekst me shkronja të vogla i cili tregon vendin dhe datën e emetimit të parasë, dhe nën atë tekst gjendet nënshkrimi i Guvernatorit dhe teksti "Гувернер" (Guvernator).

Në pjesën e poshtme, mes çerekut të tretë dhe të katërt të parasë, është shkruar mikroteksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë). Nën të qëndron teksti "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 3 mm i lartë.

Në këndin e djathtë të poshtëm të çerekut të fundit qëndron numri "50", 5 mm i lartë.

Motivi bartës i pamjes së prapme të parasë me vlerë 50 denarë, është gravura e Arhangel Gavrililit, detal i afreskës së altarit Virgjëresha Maria me Jezu Krishtin në fron, Kisha Shën Gjergji (viti 1191), fshati Kurbinovë, Resnjë.

Në pjesën e sipërme dhe të poshtme të parasë është vendosur mikroteksti "НБРМ" (BPRM) dhe "50", i cili përsëritet në sfonde të ndryshme, në kombinim negativ dhe pozitiv me ngjyra që përputhen me ngjyrat e parasë.

Në çerekun e parë të këndit të majtë të lart qëndron numri "50", 5 mm i lartë.

Mes çerekut të parë dhe të dytë gjendet tekst "Народна банка на Република Македонија" (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë), 3 mm i lartë. Numri serik i parasë i cili përmban 2 shkronja dhe 6 numra, është i shtypur në pjesën e mesme të çerekut të parë dhe të tretë të parasë në pozicion vertikal, ndërsa në çerekun e katërt të parasë, në pozicion horizontal.

Në pjesën qendrore të pjesës së sipërme të çerekut të dytë, është i shkruar teksti "Архангел Гаврил - Св. Ѓорѓи, XII век - с Курбиново" (Arhangel Gavrilili - Shën Gjergji, shek. XII - fshati Kurbinovë).

Në pjesën e sipërme të djathtë të çerekut të dytë gjendet elementi i regjistrimit - portret i stilizuar i Arhangel Gavrililit.

Në pjesën qendrore të majtë dhe pjesën qendrore të djathtë të parasë, është vendosur një vizatim i stilizuar i pëlhurës së veshjes së Arhangelit, i cili kur paloset para ja formon pamje të plotë.

Në këndin e poshtëm të majtë të çerekut të tretë gjendet teksti "Педесет денари" (Pesëdhjetë denarë), 5 mm i lartë.

Në këndin e majtë të çerekut të katërt gjendet numri "50", 18 mm i lartë. Në hijen e numrave ka shirita ngjyrash që përmbajnë shkronjat "НБРМ" (BPRM) dhe numrin "50" që përsëritet.

Kartëmonedhat janë të shtypura në nëntë ngjyra, dhe në pjesën e përparme dominon ngjyra e kaltër, me nuanca ngjyrë hiri në gravurat që shtrihen.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/XIV-4/2016
15 dhjetor viti 2016
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov